



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.9/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ferki Xhaferi dhe Adnan Konushevci anëtarë, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar Albion Bushati nga Gjermania, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ lidhur me mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahën me datën 17 tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 25.08.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli i paraqitur nga Albion Bushati nga Gjermania, me të cilin kërkon që të përfshihet në listën e votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahën me datën 17 tetor 2021.

A r s y e t i m

Me datën **23.08.2021** PZAP-i ka pranuar një apel nga Albion Bushati nga Gjermania, në të cilën pretendohet se aplikimi është refuzuar për shkak që nuk ja kam bashkangjitur Formularit edhe një Dokument të Kosovës por vetëm Dokument identifikimi të vendit ku jetojë (Gjermani). Duke u bazuar në Email-in që më është dërguar si njoftim nga KQZ, unë ja kam bashkangjitur vetëm pasaportën e vendit ku jetojë si identifikim. Sepse në atë Email shkruan: "Ju keni pranuar këtë njoftim në mënyrë automatike sepse keni aplikuar suksesshëm për regjistrim në Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 14 shkurt 2021." "Pas plotësimit dhe nënshkrimit të formularit për aplikim, ju mund ta dërgoni përmes e-mailit, së bashku me njërin nga kopjet e vlefshme të dokumentit identifikues, kopje të pasaportës, kopje të lejes së vozitjes të Republikës së Kosovës, ose një kopje të dokumentit të vlefshëm të identifikimit të shtetit ku jetoni (letërnjoftim ose pasaportë). " Pra, në Email shkruan një kopje të dokumentit identifikues të Republikës së Kosovës OSEnjë kopje të dokumentit identifikues të vendit ku jetoni!! Nuk shkruan DHE por OSE! Duke u bazuar në këtë unë kam kuptuar që mjafton vetëm njëra nga dokumente, AJO OSE KJO!! Nuk shkruante ajo DHE kjo! Përkundër kësaj unë jam regjistruar suksesshëm edhe në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 14.02.21!

Përgjigje në ankesë ka paraqitur KQZ, me të cilën ka theksuar se ka dërguar vetëm dokumentin e huaj të identifikimit, duke dëshmuar identitetin. Por nuk ka asnjë dokumenti me të cilin do të vërtetohej kriteri ligjor për tu përfshirë si votues në listën e votuesve jashtë Kosovës.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoj të gjitha pretendimet e apelit, në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli, pasi shqyrtoi lëndën konstatoi se apeli është i pabazuar pasi që parashtruesi i apelit gjatë aplikimit të tij për regjistrim për votim jashtë Kosovës, nuk i ka plotësuar kriteret të cilat kërkohen në bazë nenit 5.1 pika a) të LZP-së ku përcaktohet: "*çdo person ka të drejt për të votuar nëse është i regjistruar si qytetar i Kosovës në Regjistrin Qendror Civil të Kosovës*", si

dhe dispozita e nenit 3.1 të Rregullës Zgjedhore 03/2013 të KQZ-së ku përcaktohet se: **“votuesi me zotësi juridike jashtë Kosovës mund ta hedh fletëvotimin për zgjedhjet në qoftë se është regjistruar si banorë i përhershëm i Kosovës në Regjistrin Qendror civil”**. Në rastin konkret parashtruesi i Apelit nuk ka bashkangjitur në formularin për regjistrim drejtuar KQZ-së, ndonjë dokument valid të Republikës së Kosovës, e as me apelin drejtuar PZAP-së nuk e ka bërë një gjë të tillë.

Paneli shqyrtoi me kujdesë pretendimet e apeluesit në apel se i njëjti përmes emailit pretendon se ka ra në lajthim duke menduar se ka mundësi që edhe me dokument valid të shtetit ku jeton mund të regjistrohet në listën e votuesve jashtë Kosovës, mirpo këto pretendime i refuzoi si të pa bazuara. Në rastin konkret parashtruesi i apelit në momentin e refuzimit të aplikimit nga ana e KQZ-së, për regjistrim jashtë Kosovës, së bashku me apelin e ushtruar në PZAP, është dashur që të bashkangjente dokumentin valid të Republikës së Kosovës, por nuk e ka bërë një gjë të tillë, prandaj në mungesë të provave paneli refuzoi në tërsi apelin si të pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës Paneli, vlerësoi se parashtruesi i apelit në momentin e aplikimit për regjistrim për votim jashtë Kosovës dosja e tij nuk ka qenë e kompletuar dhe nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuara siç parashihet me dispozitat e nenit 5.1 pika a) të LZP-së dhe të Rregullës Zgjedhore 03/2013 të KQZ-së dhe nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuara.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par.3, 118 par.1, 122 par.1 pika a) të LZP-së, si dhe nenit 11 par.6 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
A nr. 9/2021 më datën 25.08.2021



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.